

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

27.02.2024

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “Atom” shpk & “ALBITAL - CANON” shpk & “Axians Albania” shpk, me adresë, Rruga Islam Alla, Pallati nr. 56, Kati 1, Njesia Bashkiake nr.10, Tirane.

Procedura e prokurimit: “hapur sherbime mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-90873-12-13-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “CyberRecovery (Rinovimi i infrastruktures se datacenter per pajisjet “end of life” ne business continuity”

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 101 datë 18 Dhjetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë Ofertuesit si mëposhtë me vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Atom” shpk & “ALBITAL - CANON” shpk & “Axians Albania” shpk, Atom shpk me Numer NIPT L22203042N, “ALBITAL - CANON” shpk me nr. NIPT J91524502R dhe “Axians Albania” shpk me nr. NIPT K52207006Q me vlere oferte 174,993,500 (Njeqind e Shtatedhjete e kater milion e nenteqind e nentedhjete e tre mije e peseqind) leke pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “OVLA Systems” shpk me Numer NIPT M11423019O, vlere e ofertes 178,090,000 (Njeqind e Shtatedhjete e tete milion e nentedhjete) leke pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit eshte skualifikuar Ofertuesi si mëposhtëm:

Operatori Ekonomik “OVLA Systems” shpk pasi:

1. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 8 “Kriteret e perzgjedhjes / kualifikimit”, pika 2. Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, shkronja “b” ka kerkuar qe:

Ofertuesi duhet te paraqese Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “OVLA Systems” shpk, nuk ploteson kete pike te Kriterëve te perzgjedhjes pasi nga verifikimi rezulton se nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas Shtojces nr. 3.

2. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 8 “Kriteret e perzgjedhjes / kualifikimit”, pika 2. Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.2.1 e Kapacitetit ekonomik dhe financiar ka kerkuar qe:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 70,000,000 (Shtatedhjetë milion) leke pa TVSH.

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “OVLA Systems” shpk, nuk ploteson kete pike te Kriterëve te perzgjedhjes/ kapacitetet financiare dhe ekonomike pasi nga verifikimi rezulton se nuk permbushet vlera e kerkuar e xhiros per vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022.

3. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 8 “Kriteret e perzgjedhjes / kualifikimit”, pika 2. Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.3.1 e Kapacitetit teknik ka kerkuar qe:

Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në një vlerë jo më të vogël se 70,000,000 (Shtatedhjetë milion) leke pa TVSH.

- a) Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kerkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “OVLA Systems” shpk, nuk ploteson kete pike te Kriterëve te perzgjedhjes/ kapaciteti teknik pasi nga verifikimi rezulton se nuk permbushet vlera e kerkuar per shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

4. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 8 “Kriteret e perzgjedhjes / kualifikimit”, pika 2. Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.3.3 e Kapacitetit teknik ka kerkuar qe:

Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen e produkteve/shërbimeve/garancive. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota dhe detaje për kontaktin dhe referencën e këtij prokurimi. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të lëshuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “OVLA Systems” shpk, nuk ploteson kete pike te Kritereve te perzgjedhjes/ kapaciteti teknik pasi nga verifikimi rezulton se nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi/Distributori te Autorizuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “Atom” shpk & “ALBITAL - CANON” shpk & “Axians Albania” shpk, me adresë, Rruga Islam Alla, Pallati nr. 56, Kati 1, Njesia Bashkiake nr.10, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 174,993,500 (Njeqind e Shtatedhjete e kater milion e nenteqind e nentedhjete e tre mije e peseqind) leke pa TVSH / totali i pikëve të marra 100 është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë OSHEE GROUP sh.a / Njesia e Prokurimit me adrese Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO



JO X